



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6672 Prot.

Roskovec, më 04.12 2020

VENDIM

NR 34 .DATË 02.12 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN TETOR 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 26.10.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Tetor 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Kadri Hyska**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: [www.bashkiaroskovec.gov.al](http://www.bashkiaroskovec.gov.al)

Nr. 5704, Prot.

Roskovec, më 27.10.2020

Procesverbal Nr.10

*-I mbajtur sot, date 26.10.2020, ora 14, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite si me poshte :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shtator 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Shtator 2020.
5. Për miratimin e listës emërore të kërkesave për individë/familje që aplikojnë për cdo program social të strehimit.
6. Për miratimin e kërkesës së Bankers Petroleum Albania Ltd për përdorimin me kundërshpërblim të pasurisë në pronësi të Bashkisë Roskovec.
7. Për dhënien në përdorim me kundërshpërblim të pasurisë në pronësi të Bashkisë Roskovec.
8. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 14<sup>00</sup>

Keshilltaret prezent: A. Kola, E. Çepele, L. Goga, B. Kuka, T. Kuka, D. Hoxha, K. Hyska, A. Hazizi, V. Doga ni, A. Sheme, H. Beqiraj, B. Toska, M. Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : Kudret Kuka, Viktor Mata, Rrapi Hazizi, Lumturi Hoxha, Bujar Çobo, Genci Hoxha, Vjollca Bakaj, Valbona Stani.

Prezent nga administrata e bashkise: Kryetarja e bashkise, Dr. Juridike, P/Z/juridike, P/Z. ndihmes ekonomike. Prezent dhe qytetati Meti Ngjeqari.

Me plotesimin e kuorumit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 13 keshilltare. Kryetari fillon me mbledhjen.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites dhe miratohet unanimsht me 13 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Gusht 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron ne lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar.Sqaron ndarjen e vendimeve sipas karakterit te tyre,vendimet e nisura ne Prefektura per konfirmim dhe kthimin e pergjigjes nga Prefektura.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Leksi-per ceshtjen e monitorimit nga bordi i kullimit,i cili duhet te monitoroje hedhjen e mbetjeve inerte ne kanale dhe jo ndermarrja e pastrimit.Kryetarja sqaron se kjo kishte te bente me ceshtjen qe keni adresuar ju,monitorimi do veje tek bordi i kullimit jo tek ndermarrja e pastrimit.Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-30 Shtator 2020.

Elmazi-ne listat e 6% disa jane larguar dhe disa jane futur,sa eshte numri i familjeve qe kane bere kerkese ne 6%?Elisi-kerkesa eshte ne baze te sistemit,familjet qe nuk plotesojne piket ne sistem,ne mundohemi qe ti trajtojme ne 6%.Jane 4 familje qe nuk kishin plotesuar piket,familjet e tjera ishin me penalitet.Elmazi-si ka mundesi qe nje familje muajin e pare ishte ne 6% dhe muajin e dyte eshte hequr?Elisi jep sqarimet ligjore.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

5.Per miratimin e listes emerore te kerkesave per individe/familje qe aplikojne per cdo program social te strehimit.

Elmazi-kerkon sqarim nga komisioni per listat.P/Z/juridike sqaron se eshte bere njoftimi per plotesimin e formularit tip,u paraqiten qytetaret dhe bene kerkesat.Elmazi-mund te kete qytetare te tjere?Leksi-jam pak i paqarte per piken 2,cfare procedurash do jene me pas?Kryetarja-procedura e plote eshte lidhja e aktmarrveshjes me Entin e Banesave,i cili i hap rruge financimit te projektit dhe procedures se shpronесimit.Pa garantuar truallin e lire enti nuk ben dot prokurimin e projektit.Do ju lutem juve qe nese ka akoma qytetare apo cifte te reja te paraqiten ne bashki per te aplikuar.Kjo eshte nje mundesi shume e mire per ciftet.Nese do kete nevoja ne rritje,ne do bashkepunojme me entin.Dr.Juridike sqaron se komisioni do i vleresojte keto kerkesa dhe do nxjere se kush jane fituesit.Leksi-pervec ketij projekti,ne kemi kerkuar nje liste emrash per perfituesit e programit per permiresimin e kushteve te banimit,per kete mbledhje.Kryetarja-do e sjellim tani.Aleksander-ne do miratojme listen apo jemi pjese selektive ne kete gje?Kryetarja sqaron se kete vendim e kerkon Enti i Banesave,ketu miratohet lista e kerkesave,ne momentin qe do mbarohen banesat,atehere do ju vij propozimi qe ju te votoni perfituesit.E drejta e kerkesave eshte e hapur per te sjelle kerkesen.Leksi-pyct per hyrjet e pandara tek godina 3 kateshe.Kryetarja sqaron se per 5 apartamentet qe kane ngelur,ne po shikojme kategorite qe kane me teper nevojte.Hidhet ne votim projekti i listes emerore te kerkesave te individeve/familje qe aplikojne per cdo program social te strehimit,dhe miratohet unanimisht me 13 vota pro.

6.Per miratimin e kerkeses se Bankers Petroleum Albania Ltd per perdorimin me kundershperblim te pasurise ne pronesi te Bashkise Roskovec.

Dr.Juridike sqaron projektin,kerkesen e Bankersit per marrjen me qira te pronave me te cilat eshte zgjidhur kontrata e qirase me qiramarrёsit e pare.Kryetarja-keto jane prona te bashkise,i jane dhene me kontrate qiraje 2 qytetareve,keta qytetare ja kishin dhene me nenkontrate Bankersit.Nga verifikimet rezulton se kjo kontrate me komunен ishte prishur sepse nuk e kishin perdorur per arsyen qe e kishin marr.Toka mbeti e lire juridikisht por jo fizikisht sepse e ka mar Bankersi nga keta qytetare.Prandaj po e sjellim kete projekt,per te lidhur kete marrveshje me Bankersin.Elmazi-midis individit dhe kompanise ka gjera qe nuk shkojne?Pse duhet tja japim kompanise,nuk ka



qytetare qe mund tju duhet kjo toke? Kryetarja sqaron se Bankersi eshte ne te drejten e pales qe ka mar toke me qera dhe ka investuar ne kete toke, sepse ka pas kontrate me individin. Qe te arrijme atje ku thua ti, i bie qe ti kerkojme Bankersit ta ktheje token ne gjendjen e meparshme. Ceshtja do vej ne gjykate sepse ai thote qe une kam kontrate per 30 vjet dhe kam investuar. Ne gjykojme mbi bazen e faktit qe kemi tani, si eshte me mire te presim gjyqin, apo te lidhim marrveshje me Bankersin dhe ato leke ti shtohen bashkise tone? Leksi-materiali eshte i qarte, ne kuptojme qe nuk ka panalitete kur keta largohen vet, investimi eshte bere ne vater pusi, per mua ti mari bashkia ta shfrytezojme, ne duam financim. Kryetarja-toka sot eshte e zene, qe te hiqet Bankersi minimum do kohen e vet. Hidhet ne votim projekti per miratimin e kerkeses se Bankersit per perdorimin me kundershperblim te pasurise prone e Bashkise Roskovec dhe miratohet unanimitisht me 13 vota pro (3/5).

7. Per dhenien ne perdorim me kundershperblim te pasurise ne pronesi te Bashkise Roskovec.

Dr. Juridike sqaron projektin per dhenien ne perdorim per sherbim kafe te pasurise ne pronesi te Bashkise Roskovec sipas materjalit te paraqitur. Kryetarja sqaron se procedura do te jete ligjore dhe e hapur ne zgjedhjen e operatorit, do e rregulloje sipas kushteve qe do i vendosi bashkia, kundrejt nje tarife te caktuar qe do i vendosi bashkia sipas ligjit. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht me 13 vota pro (3/5), sipas sqarimit te bere nga zyra perkatese dhe kryetarja.

8. Diskutime dhe komente te qytetareve.

Elmazi-ne lagjen tone lene per te deshruar 3 rruge, jane afersisht 3 km, ka shume barera, po pati mundesi te shtrohet jane 3 rruge nga 100 m. Kryetarja-nuk jane 3 por 5 dhe nuk jane nga 100 m por diku me shume e diku me pak, buxheti i bashkise do tju vij shume shpejt me planifikimet e bera. Buxheti i 2021 do te jete shume i ngushtuar, pas qershorit do te bejme planifikimin buxhetor per 3 vitet. Elmazi-nga punimet e kompanise jane çare asfaltet, ka shume gropa nuk kalojme dot me makine. Tek Lamajt mungojne kazanet, tu vihet edhe atyre qytetareve kazane. Kryetarja-ne kontinieret i ndam, do e planifikojme vitin tjeter, vendosja e kontinierëve eshte me norme. Vera-kemi nje rruge dhe kanalin e parcelave te zallit. Leksi-problemi i OSHEE-se te vij nje perfaqesues, tek qendra shendetsore ka mungese mjeku dhe pergjegjesi, kapaket e pusetave jane te thyera te gjitha, shatervanet te liben ne nje orar me te zgjatur, shkallet e shkollës, pusetat nga lokali i R. Shurdhes nuk jane, stenda e publikimeve, per prishjet e ujesjellesit ka mar carje asfalti dhe tek shtepia e xha Petit, duhet te hedhin stabilizant. Pyet edhe per skrepin qe kemi kaluar ne keshill, kryetarja sqaron se jane bere procedurat. Hekurani-tek fusha e sportit eshte bllokuar nje kanal i ujrave te bardha, rruga Marinez-Kuman ka shume ferra dhe kallemba. Dorinela-perroi ne Vidhishte ka nevojë per pastrim. Kryetarja sqaron se ky nuk ishte investim i bashkise por i bordit, nese do rakordojme vitin qe vjen me bordin do mundohemi ta bejme. Mateus-nuk besoj se sdo kene pasur deshire banoret per transportin, duhej te kishte nje komunikim nga kryeplaku me banoret. Mateus-ne lidhje me dizifektimin e shkollave, sidomos atje ku ka pasur raste te behen me te shpeshta. Kryetarja-kemi bere dizifektime dhe do i shtojme edhe me teper. Kryetari i keshillit mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

